



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:137082
Datë: 29.02.2024
Numri i dokumentit: 05391004

C.A.P.nr.1357/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Besnik Bislimaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores M. K. nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson S. K., avokat me seli në lagjen Ulpiana C-., /6 në Prishtinë, kundër debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) në Prishtinë, me seli në Prishtinë, për përmbarimin e dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditores, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1865/20, të datës 17.03.2023, më datë 28.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditores M. K. nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1865/20, i datës 17.03.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.1865/20, të datës 17.03.2023, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET si i bazuar Prapësimi i debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) në Prishtinë. II. SHFUQIZOHET Urdhrit përmbarimor P.nr.1412/20 i datës 28.05.2020 i caktuar nga përmbaruesi privat A. M. në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, kreditorja përmes të autorizuarit të saj, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që ta aprovojë ankesën e kreditores dhe ta prish aktvendimin e ankimuar ashtu që të lihet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.1412/20, i datës 28.05.2020. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se debitori të ketë parashtruar përgjigje në ankese.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, nenit 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditores është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorja M. K., me datë 28.05.2020, përmes të autorizuarit të saj ka paraqitur propozim për përmbartim pranë përmbartuesit privat A. M., për lejimin e përmbartimit në bazë të titullit ekzekutiv, vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-.../94 i datës 10.02.2020 dhe vendimit Nr. .../2020, të datës 19.05.2020, përmes së cilit ka kërkuar që të detyrohet debitori që në emër të borxhit, t'i paguajë kreditores shumën prej 1,124.68 €, në afat prej shtatë ditësh së bashku me shpenzimet e procedurës në vlerë prej 156,00 €.

Përmbartuesi Privat A. M., duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, me Urdhrin P.nr.1412/20, të datës 28.05.2020 e ka caktuar përmbartimin në këtë çështje përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, me datë 10.06.2020, ka ushtruar prapësim përmes së cilit e ka kundërshtuar propozimin për përmbartim për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me arsyetim se propozimi për përmbartim është iniciuar me anë të aktit administrativ i cili nuk është bërë i ekzekutueshëm ngase ndaj të njëjtit është e lejuar e drejta e paraqitjes së ankesës e për të cilat arsye ka propozuar që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar ndërsa urdhri për lejimin e përmbartimit të anulohet ashtu që propozimi për përmbartim të hedhet poshtë si i bazë.

Me përgjigje në prapësim kreditorja i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura me anë të prapësimit si të pabazuara duke theksuar se debitori nuk ka paraqitur asnjë dëshmi lidhur me përmbartjen e obligimit të tij siç nuk ka paraqitur asnjë provë lidhur me pretendimet e paraqitura në prapësim, prandaj ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr.1412/20, i datës 28.05.2020 të vërtetohet si dhe të detyrohet debitori që kreditorit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit, me aktvendimin e atakuar, ka vendosur që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se gjykata pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimit, Vendimi i Inspektoratit të punës nr. 01 Nr. 21-1715/94 i dt. 10.02.2020 dhe Vendimi për korrigjimin e gabimeve Nr. 01/21-1178 i dt. 18.11.2020, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, kjo pikërisht për arsye se Vendimi i Inspektoratit të punës nr. 01 Nr. 21-.../94 i dt. 10.02.2020 dhe Vendimi për korrigjimin e gabimeve Nr. 01/21-... i dt. 18.11.2020 janë dokumente të papërshtatshme për përmbartim. Në

Vendimin e Inspektoratit të punës nr. 01 Nr. 21-...../94 i dt. 10.02.2020 dhe në Vendimin për korigjimin e gabimeve Nr. 01/21-..... i dt. 18.11.2020 nuk është treguar shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Duke qenë se vetëm dispozitivi - pjesa urdhëruese përmbahet dhe për faktin se në këto dispozitive të vendimeve të theksuara qartësisht nuk është theksuar shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, ndaj gjykata vëren se këto vendime të theksuara nuk janë dokumente të përshtatshme për përmbarim. Ndaj gjykata vendosi që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhrin përmbarimor P.nr.1412/20 i datës 28.05.2020 i caktuar nga përmbaruesi privat.

Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 27, paragrafi 1 dhe 73, paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP).

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditorës, Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Në rastin konkret pala debitore me prapësim i është referuar papërshtatshmërisë së dokumentit përmbarimor, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbarimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përmbarim, konform dispozitave ligjore në fuqi. Andaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret dokumenti përmbarimor është i papërshtatshëm për përmbarime edhe nga fakti se me nenin 27 të LPP, në mënyrë shprehimore është paraparë se *“dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për përmbarim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përmbarimor, Vendimi i Inspektoratit të Punës nr.01 Nr.21-1715/94, i datës 10.02.2020, i njëjti në dispozitiv nuk e përmban shumën dhe kohën e përmbushjes së detyrimit, e që nuk dihet se si do të ekzekutohet një vendim i tillë. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se qëndrojnë pretendimet prapësuese të debitorit në lidhje me papërshtatshmërinë e përmbarueshmërisë së dokumentit përmbarimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, andaj për Gjykatën e Apelit gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorës.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes pati parasysh pretendimet e palës kreditore se në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur vendimin korigjues Nr.01/21-....., të datës 18.11.2020 i cili është nxjerrë më pas, mirëpo sipas kësaj gjykate janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara, për shkak se me shikim në shkresat e lëndës vërtetohet se me rastin e parashtimit dhe lejimit të propozimit për përmbarrim i njëjti është lejuar në bazë të vendimit nr.01 Nr.21-...../94, të datës 10.02.2020, i cili nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për tu konsideruar dokument i rregullt përmbarrues dhe fakti se është bërë korigjimi i këtij vendimi nuk ndikon në ndryshimin e vendimit ngase procedura përmbarrimore është filluar dhe përmbarrimi është lejuar në bazë të dokumentit përmbarrimor që është Vendimi i Inspektoratit të Punës nr.01 Nr.21-...../94, i datës 10.02.2020. Duke i vlerësuar të gjitha pretendimet, gjykata ka vlerësuar se pala kreditore as gjatë procedurës e as me ankesë nuk ka propozuar plotësimin e propozimit përmbarrimor, por vetëm pas lejimit të përmbarrimit në bazë të dokumentit përmbarrues fillestar, ka bashkangjitur korigjimin e atij vendimi, andaj dhe gjykata e shkallës së parë sipas prapësimit së debitorit ka qenë e detyruar që të veprojë konform dispozitave ligjore dhe me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, pasi që korigjimi i vendimit Nr.01/21-....., i datës 18.11.2020, nuk ka qenë pjesë e propozimit për përmbarrim. Eventualisht pala kreditore mund të parashtrojë propozim të ri në bazë të vendimit i cili i plotëson kushtet për tu konsideruar dokument i rregullt përmbarrimor.

Nuk janë pranuar pretendimet e kreditorës lidhur me atë se vendimi i Inspektoratit të Punës nuk paraqet titull ekzekutiv, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit me dispozitën e nenit 24 paragrafi 5 të LPP-së përcaktohet se: *“Përmbarrimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarrimin”*, ndërsa me Ligjin për Inspektoratin e Punës në Kosovë LIGJI Nr. 2002/9, në nenin 6.4 është përcaktuar se: *“Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit”*, ndërsa me dispozitën e nenit 144 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Ligji Nr. 05/L - 031, përcaktohet se: *“Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues”*. Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, pasi që në kuptim të dispozitave të lart cituara përmbarrimi mund të lejohet edhe në rastet kur vendimi i dhënë në procedurë administrative nuk është bërë përfundimtar vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarrimin e në rastin konkret vendimi përmban klauzolën se ankesa e ushtruar në Vendimin e Inspektoratit të Punës nuk e shtyn ekzekutimin.

Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike, sepse gjykata përmbarrimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarrimi, përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarrimit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se “*në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual*”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P.nr.1357/2023, më datë 28.02.2024

Gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v